



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR  
SENATI AKADEMIK

**SHPALLJE**  
**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE DHE SEKRETARIT TË KOMISIONIT**  
**INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE SI DHE TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË**  
**APELIMIT**

Senati Akademik pranë Universitetit "Eqrem Çabej" mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 131 si dhe Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, neni 6 dhe neni 39, në mbledhjen e datës 21.05.2024 vendosi të shpall fillimin e regjistrimit për anëtarë të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, për sekretar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve dhe për anëtar të Komisionit të Apelimit. Aplikimi bëhet pranë sekretarisë së Senatit Akademik në datat 21.05.2024 dhe 22.05.2024 (ora 08.00 - 16.00).

**KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE (KIZ)**

**1. Përbërja e KIZ-it**

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit Institucional Zgjedhor është 5 (pesë), sipas kësaj shpërndarje:

- a. 2 (dy) përfaqësues të personelit akademik për FESHSH;
- b. 1 (një) përfaqësues i personelit akademik për FSHN;
- c. 1 (një) përfaqësues i personelit akademik për FE;
- d. 1 (një) përfaqësues i studentëve;
- e. Sekretari i KIZ-it (anëtar pa të drejtë vote).

**2. Të drejtën për të aplikuar si anëtar në KIZ e kanë individët që janë:**

- a. personel akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar pranë Universitetit "Eqrem Çabej";
- b. student me kohë të plotë pranë Universitetit "Eqrem Çabej".

*Anëtari i KIZ, përfaqësues i personelit akademik, nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtuese dhe/ose për anëtar në organet drejtuese, të çdo niveli.*

3. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikuesit nga rradhët e personelit akademik:**
  - a. fotokopje e letërnjoftimit ID;
  - b. curriculum vitae (CV);
  - c. vërtetim me anë të të cilit të vërtetohet se kandidati është anëtar i personelit akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pa caktuar.
4. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim, nga rradhët e studentëve:**
  - a. fotokopje e letërnjoftimit ID;
  - b. vërtetim me anë të të cilit të vërtetohet se kandidati është student me kohë të plotë pranë Universitetit “Eqrem Çabej”.
5. **Të drejtën për të aplikuar si sekretar i KIZ e ka:**
  - a. personel akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar pranë Universitetit “Eqrem Çabej”.

*Sekretari i KIZ nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtuese dhe/ose për anëtar në organet drejtuese, të çdo niveli.*

#### 6. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim.

- b. fotokopje letërnjoftimit ID;
- c. curriculum vitae (CV);
- d. vërtetim me anë të të cilit të vërtetohet se kandidati është anëtar i personelit akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pa caktuar.

### KOMISIONI I APELIMIT (KA)

#### 1. Përbërja e Komisionit të Apelit

Komisioni i Apelit (KA) përbëhet nga 3 (tre) anëtarë përfaqësues të personelit akademik me angazhim me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar, nga 1 (një) për secilën njësi kryesore.

#### 2. Të drejtën për të aplikuar si anëtar në Komisionin e Apelit e kanë individët që janë:

- a. personel akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar pranë Universitetit “Eqrem Çabej”;
- b. kanë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar, jo më pak se 3 (tre) vjet;
- c. nuk kanë qënë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë.

*Anëtari i KA nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtuese dhe/ose për anëtar në organet drejtuese, të çdo niveli.*

#### 3. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim si anëtar në Komisionin e Apelit:

- a. fotokopje e letërnjoftimit ID;

---

Pruga "Studenti", Lagjia "18 Shtatori" Gjirokastër Kodi Postar 6001 Tel: 084263408

Web: [www.uogj.edu.al](http://www.uogj.edu.al), email: [rektori@uogj.edu.al](mailto:rektori@uogj.edu.al)

- b. curriculum vitae (CV);
- c. vërtetim me anë të të cilit të vërtetohet se kandidati është anëtar i personelit akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pa caktuar.
- d. formular vetëdeklarimi.

Ju faleminderit !

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr. Bektash MEMA**

